REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 348/5 **Prot** **Datë** 18/5 **2022**

VENDIM
Nr. 17, Datë 11.05.2022

"PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË KURSEVE EKSTRAKURRIKULARE TË GJUHËVE TË HUAJA, NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS "

Referuar Ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutit të UT-së; Vendimeve të Senatit Akademik të UT-së nr. 34, datë 21.11.2018 dhe nr. 8, datë 05.04.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së kurseve ekstrakurrikulare të gjuhëve të huaja, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës, si vijon:

- Programe për Gjuhën Italiane niveli A1,A2, B1,B2,C1,C2
- Programe për Gjuhën Angleze niveli A1.1,A1.2,A2, B1,B2.1,B2.2,C1,C2
- Programe për Gjuhën Gjermane niveli A1,A2, B1,B2,C1.
- Programe për Gjuhën Frënge niveli A1.1,A1.2,A2.1, A2.2,B1,B2.
- Programe për Gjuhën Spanjolle niveli A1,A2, B1,B2.
- Programe për Gjuhën Greke niveli A1,A2, B1,B2,C1.
- Programe për Gjuhën Turke niveli A1,A2, B1,B2,C1.
- Programe për Gjuhën Ruse niveli A1,A2, B1,B2,C1.
- Programe për Gjuhën Kroate niveli A1,A2, B1,B2.
- Programe për Gjuhën Hebraike niveli A1,A2, B1,B2.
- Programe për Gjuhën Arabe A1,A2, B1,B2,C1.
- Programe për Gjuhën Polake A1,A2.

2. Miratimin e tarifës për ndjekjen e kursit të gjuhës së huaj, sipas planit financiar të miratuar nga FGJH për secilën gjuhë, si vijon:

- Niveli A1,A2, tarifa 18.000 lekë/ student.
- Niveli B1,B2, tarifa 24.000 lekë/ student.
- Niveli C1,C2, tarifa 28.000 lekë/ student.

3. Si rregull, minimumi i numrit të studentëve për kurs të gjuhës, të jetë 8 (tetë) studentë.

4. Burimi i financimit për zhvillimin e këtyre kurseve do të jetë tarifa e kursit për gjuhë, dhe pa efekte financiare shtesë për Buxhetin e UT-së.

5. Pagesat për orët mësimore të personelit akademik të brendshëm të FGJH, të cilat do të konsiderohen si orë suplementare, do të kryhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar. Personeli akademik i jashtëm, nuk mund të paguhet më shumë se 120 orë, dhe pagesa të kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

6. Shpërblimi për orët shtesë të personelit ndihmës akademik me karakter akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ, si dhe personelit administrative, të kryhen sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar, si dhe me miratim të Bordit të Administrimit.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Asoc. Dr. Aldela KARAPICI